



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ
NDERMARJA UJESJELLES KANALIZIME**

Nr. ____ Prot.

Kamëz më ____ . ____ . 2020

FORMULAR I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Për: Operatori ekonomik ” **Liqeni VII**” sha , me adresë : Lagja 14, Shkozet, Durrës.

* * *

Procedura e prokurimit: “**Kërkese per propozim**”

Numri i referencës së procedurës/lotit: **REF-46339-12-17-2019**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **Ndërtim lunja e re KUN rruga Mati Lagjja Valias**

Fondi limit : **2,487,835** (dy milion e katërqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e tetëqind e tridhjetë e pesë) **lekë pa tvsh,**

Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin: **30(tridhjetë) dite nga data e lidhjes se kontrates.**

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [____ . ____ . 2019] /

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët **X** oferta ekonomikisht më e favorshme
Njoftojmë se, kanë qënë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit te zhvilluar me date **30.12.2019** këta ofertues:

1. “ **Liqeni VII**” sha **K01730502W**
Emri i plotë i shoqërisë numri i NIPT-it
është paraqitur me ofertën ekonomike me vlerë **2,355,490** lekë pa tvsh, dhe **2,826,588** lekë me tvsh.
2. “**Ndërtimi**” shpk **K11325002C**
Emri i plotë i shoqërisë numri i NIPT-it
është paraqitur me ofertën ekonomike me vlerë **1,915,300** lekë pa tvsh, dhe **2,298,360** lekë me tvsh.
3. “**ALB-KON**” shpk & “**2AF ALBANIA GROUP**” shpk **K06626411C & L32005501M**
Emri i plotë i shoqërisë numri i NIPT-it
është paraqitur me ofertën ekonomike me vlerë **2,231,750** lekë pa tvsh, dhe **2,678,100** lekë me tvsh.
4. “**2N**” shpk **L31615017L**
Emri i plotë i shoqërisë numri i NIPT-it
është paraqitur me ofertën ekonomike me vlerë **1,961,415** lekë pa tvsh, dhe **2,353,698** lekë me tvsh.
5. “**SARK**” shpk **K52531415H**
Emri i plotë i shoqërisë numri i NIPT-it
është paraqitur me ofertën ekonomike me vlerë **2,051,170** lekë pa tvsh, dhe **2,461,404** lekë me tvsh.

Operatore te skualifikuar

1. “2N” shpk

Emri i plotë i shoqërisë

L31615017L

numri i NIPT-it

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

1. Eskavatori me goma nuk ka:
 - Certificate pronesia
 - Leje qarkullimi
 - Kolaudim
 - Siguracion
2. Kamioni AA619KY është marrë me qira nga Shoqëria Pro-Team shpk dhe ka një leje transporti mallrash brenda vendit për llogari të vet dhe jo për të tjerë dhe me qira cka do ta lejonte shoqërinë pro-team ta japë mjetin me qira. Në rastin konkret ky mjet mund të qarkullohet vetëm nga Shoqëria Pro-Team shpk dhe jo 2N shpk.
3. Në fakturën e paraqitur për tabelë paralajmëruese të lëshuar nga “MEGATEK” me nr. SO-59847 e datës 15.09.2018, emri i Shoqërisë blerëse është e mbuluar me fakturën tatimore dhe nuk dallohet aspak nëse kjo fakturë është lëshuar për 2N shpk ose jo.
4. Në pikën 5 kërkohej “Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar punonjës të pajisur me dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik, (të vlefshme) lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial apo nga subjekte juridike private të akredituara për certifikimin e punonjësve, si më poshtë:
1(nje) punonjës teknik ndërtimi
1(nje) punonjës hidraulik
2 (dy) punonjës Manovrator
Punëtor ndërtimi(krahu) jo më pak se 7
Për punonjësit e mësipërm duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme; dëshmitë e kualifikimit të sigurimit teknik, (të vlefshme) si dhe të figurojnë në listat e shoqërisë për të paktën 3 (tre) muajt e fundit. Për manovratorët duhet të paraqitet dëshmitë e drejtimit nga DPSHTRR (të vlefshme), lëshuar nga institucionet përkatëse .”
Shoqëria 2N shpk nuk ka paraqitur asnjë Kontratë pune dhe asnjë dëshmi IQT për asnjë nga personat që do të angazhohen si punëtor krahu përveçse një deklaratë nga Administratori i shoqërisë me emrat përkatës gjë e cila as nuk është kërkuar në DST.

2. “SARK” shpk

Emri i plotë i shoqërisë

K52531415H

numri i NIPT-it Përkatësisht për

arsyet e mëposhtme:

1. Operatori ekonomik nuk plotëson kriterin 2.2.1 si vijon :
“2.2Për kapacitetin teknik: Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale të cilat vendosen nga Autoriteti Kontraktor si më poshtë:
Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:
a)Punë të ngjashme për një objekt të vetëm me vlerë 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe konkretisht 1,243,918(një milion e dyqind e dyzet e tremijë e nëntëqind e tetëmbëdhjetë)lekë pa TVSH, të realizuar gjatë tri viteve të fundit.
b)Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë tre viteve të fundit është në një vlerë sa dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet dhe konkretisht: 4,975,670 (katër milion e nëntëqind e shtatëdhjetë e pesëmijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë) lekë pa TVSH.
Pika 1/a plotësohet nga anëtarët e bashkimit të cilët kanë përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim

Plotesimi i njerit prej dy kushteve te siperpermendura e ben oferten te kualifikueshme”.

SARK shpk ka paraqitur pune te ngjashme:

- “Ndertim tombino Njesia Administrative Sheze, Bashkia Peqin” me Autoritet Kontraktor Bashkia Peqin me vlere 815,980 Leke pa tvsh
- “Blerje materiale per ndertim KUZ fshati Strum Lagjia Muskaj + Lagjia Begaj” me Autoritet Kontraktor Bashkia Roskovec me vlere 2,424,340 Leke pa tvsh.
- “Blerje materiale per ndertim KUZ Lagjia e Spitalit Roskovec” me Autoritet Kontraktor Bashkia Roskovec me vlere 1,807,960 Leke pa tvsh.
- “Ndertim trotuari Rruga Pashtriku dhe rehabilitime pjesore ne rrugica e trotuare te brendshme ne qytetin Krume” me Autoritet Kontraktor Bashkia Has me vlere 1,625,691 Leke pa tvsh.
- “Rikonstruksion i Sokakut Selam Musai ne Lagjen Palorto” me Autoritet Kontraktor Bashkia Gjirokaster me vlere 5,449,537 Leke pa tvsh.

Per sa mesiper, vetem respektivisht puna e ngjashme e pare e paraqitur (Ndertim tombino Njesia Administrative Sheze, Bashkia Peqin” me Autoritet Kontraktor Bashkia Peqin me vlere 815,980 Leke pa tvsh) ploteson kriterin e mesiperm si pune e ngjashme. Kontrata e dyte dhe e trete jane kontrata blerje materialesh nderkohe qe kontrata e katert dhe e peste jane ndertim trotuari dhe rikonstruksion sokaku (rruge e shtruar me cerpic). Pra ne total puna e ngjashme nuk ploteson dyfishin e vleres se objektit te tenderuar ose 4,975,670 Leke sic eshte kerkuar ne DST.

2. SARK shpk ka paraqitur pune te ngjashme:

- “Ndertim tombino Njesia Administrative Sheze, Bashkia Peqin” me Autoritet Kontraktor Bashkia Peqin me vlere 815,980 Leke pa tvsh
- “Blerje materiale per ndertim KUZ fshati Strum Lagjia Muskaj + Lagjia Begaj” me Autoritet Kontraktor Bashkia Roskovec me vlere 2,424,340 Leke pa tvsh.
- “Blerje materiale per ndertim KUZ Lagjia e Spitalit Roskovec” me Autoritet Kontraktor Bashkia Roskovec me vlere 1,807,960 Leke pa tvsh.
- “Ndertim trotuari Rruga Pashtriku dhe rehabilitime pjesore ne rrugica e trotuare te brendshme ne qytetin Krume” me Autoritet Kontraktor Bashkia Has me vlere 1,625,691 Leke pa tvsh.
- “Rikonstruksion i Sokakut Selam Musai ne Lagjen Palorto” me Autoritet Kontraktor Bashkia Gjirokaster me vlere 5,449,537 Leke pa tvsh.

Per sa mesiper, kontratat “Ndertim trotuari Rruga Pashtriku dhe rehabilitime pjesore ne rrugica e trotuare te brendshme ne qytetin Krume” me Autoritet Kontraktor Bashkia Has me vlere 1,625,691 Leke pa tvsh dhe “Rikonstruksion i Sokakut Selam Musai ne Lagjen Palorto” me Autoritet Kontraktor Bashkia Gjirokaster me vlere 5,449,537 Leke pa tvsh kane nisur dhe perfunduar ne vitin 2018 per te cilat as nuk eshte bere rregjistrim ne QKB per ushtrim aktiviteti dhe as nuk jane paraqitur taksa vendore te paguara. Operatori Ekonomik “Sark” shpk ka paraqitur taksat vendore per Bashkine Tirane vetem per vitin 2019 dhe Bashkine Fier per 2018-2019.

Ne vijim te kesaj llogjike, edhe ne Shtojcen 10 te DST” Deklarate mbi kontratat e lidhura apo ne proces”, SARK shpk ka deklaruar se eshte i angazhuar ne Bashkine Divjake, Bashkine Perrenjas dhe Bashkine Korce per te cilen as nuk eshte rregjistruar ne QKB vertetuar kjo sias Ekstraktit Historik dhe as nuk jane paraqitur vertetime per shlyerje taksash vendore per vitin 2019 sikurse eshte kerkuar ne DST.

3. Ne plotesim te kerkeses per paraqitjen e nje minieskavatori eshte paraqitur kontrata e qirase ndermjet SARK shpk dhe COBIAL shpk dokumentet e bashkengjitura te se ciles jane te gjitha fotokopje ne kundershtim me kerkesen ne DST *“Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.”*

4. Ne plotesim te kerkeses per paraqitjen e nje eskavatori me goma eshte paraqitur kontrata e qirase

ndermjet SARK shpk dhe z. Taulant Kulluri.

Se pari, dokumentet e bashkengjitura jane te gjitha fotokopje ne kundërshtim me kërkesen ne DST
“Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.”

Se dyti, eskavatorit me goma nuk ka:

- Certifikate pronesie
- Leje qarkullimi
- Kolaudim
- Siguracion

5. Ne piken 5 kerkohet “ *Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar punonjës të pajisur me dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik, (të vlefshme) lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial apo nga subjekte juridike private të akredituara për çertifikimin e punonjësve, si më poshtë:*

1(nje) punonjës teknik ndërtimi

1(nje) punonjës hidraulik

2 (dy) punonjës Manovrator

Punetor ndertimi(krahu) jo me pak se 7

Për punonjësit e mësipërm duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme; deshmitë e kualifikimit të sigurimit teknik, (të vlefshme) si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për të paktën 3 (tre) muajt e fundit. Për manovratorët dheshoferet e mjeteve të reja duhet të paraqitet dëshmitë e drejtimit nga DPSHTRR (të vlefshme), lëshuar nga institucionet përkatëse .”

Shoqeria SARK shpk nuk ka paraqitur asnjë dëshmi IQT për asnjë nga personat që do të angazhohen si punetore krahu përveçse një kontratë pune midis paleve. Menyra se si është përmbushur kriteri bie në kundërshtim me çfarë është kërkuar në DST.

6. Në plotësim të kriterit për kërkesën e 2 manovratorëve SARK shpk ka paraqitur:

- Z. Bashkim Zenuni shoqëruar me Kontratë pune dhe IQT por pa dëshmi manovrimi.
- Z. Taulant Xhafa shoqëruar me Kontratë pune dhe Dëshmi manovrimi por pa IQT.
- Z. Arben Kajolli në një dokument që mban emrin “dëshmi manovrimi” por në fakt mban vetëm leje drejtimi dhe CAP të zoterisë për kategoritë B, C në leje drejtimi dhe B në CAP (pra veturë dhe kamion dhe jo dëshmi për eskavatorist/automakinist/buldozerist etj sikurse kërkohej) . Shtuar kësaj, për zoterinë në fjalë nuk është paraqitur as kontratë pune dhe as IQT. Për sa më sipër, asnjë nga ata më sipër nuk e plotëson kriterin sic është kërkuar në DST si vijon citojmë “*Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar punonjës të pajisur me dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik, (të vlefshme) lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial apo nga subjekte juridike private të akredituara për çertifikimin e punonjësve, si më poshtë:*

1(nje) punonjës teknik ndërtimi

1(nje) punonjës hidraulik

(dy) punonjës Manovrator

Punetor ndertimi(krahu) jo me pak se 7

Për punonjësit e mësipërm duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme; deshmitë e kualifikimit të sigurimit teknik, (të vlefshme) si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për të paktën 3 (tre) muajt e fundit. Për manovratorët dheshoferet e mjeteve të reja duhet të paraqitet dëshmitë e drejtimit nga DPSHTRR (të vlefshme), lëshuar nga institucionet përkatëse.”

3"Ndërtimi"shpk

Emri i plotë i shoqërisë

K11325002C

numri i NIPT-it

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

- Mjeti me targat ABMT89 I paraqitur për eskavator me goma është në fakt fadrome me goma. Njekohesisht eskavatori me goma tipi Yanmar me nrFat Cdoganimi 27784Dt 30.03.2019 nuk ka:
 - Certificate pronësie
 - Leje qarkullimi
 - Kolaudim
 - Sigurim
- Operatori ekonomik nuk plotëson kriterin 2.2.1 si vijon :

"2.2 Për kapacitetin teknik: Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale të cilat vendosen nga Autoriteti Kontraktor si më poshtë:

Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:

a)Punë të ngjashme për një objekt të vetëm me vlerë 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe konkretisht 1,243,918(një milion e dyqind e dyzet e tremijë e nëntëqind e tetëmbëdhjetë)lekë pa tvsh, të realizuar gjatë tri viteve të fundit.

b)Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë tre viteve të fundit është në një vlerë sa dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet dhe konkretisht: 4,975,670 (katër milion e nëntëqind e shtatëdhjetë e pesëmijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë) lekë pa TVSH.

Pika 1/a plotësohet nga anëtarë i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim

Plotësimi i njerit prej dy kushteve të sipërpermendura e ben oferten të kualifikueshme".

NDERTIMI shpk ka paraqitur punë të ngjashme "Nërtim KUB Paskuqan 2, Vreshtë" me Autoritet Kontraktor Bashkia Kamez punë e cila sipas formularit të vlerësimit ka filluar me datën 15.07.2016 dhe përfunduar 20.10.2016 si dhe Akti i Kolaudimit është përfunduar me datë 15.11.2016. Pra puna e ngjashme ka kaluar afatin 3 vjeçar sipas Ligjit të prokurimit Publik dhe është tashmë e pavarëshme për t'u paraqitur në zbatim të kriterit të mesiperm.
- Në plotësim të kriterit : *"Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një dokument që vërteton se ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore për të gjitha vendet ku operatori ushtron aktivitet për vitin 2018,2019(Sipas QKB)sipas përcaktimeve nëLigjin nr.9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga cdo njësi e qeverisjes vendore"* Operatori ekonomik NDERTIMI shpk ka paraqitur vërtetim për vitet 2018-2019 për Bashkinë Tiranë dhe Bashkinë Korce. Njekohesisht ky Operator Ekonomik në "Deklaratën mbi kontratë të lidhura ose në proces" ka deklaruar se ka një kontratë në vazhdim me Bashkinë Kamez për të cilën nuk ka paraqitur asnjë vërtetim për shlyerje të taksave vendore.
- Operatori Ekonomik NDERTIMI shpk nuk ka plotësuar siç duhet shtojcën 1/1 ku në pikën 6 nuk ka shënuar asnjërin nga alternativat duke e bërë kështu shtojcën të pavarëshme.

4."ALB-KON"shpk & "2AF ALBANIA GROUP"shpk

Emri i plotë i shoqërisë

K06626411C & L32005501M

numri i NIPT-it

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

1. Shoqëria ALB-KON shpk nuk plotëson kërkesën e DST referuar Drejtuesit Teknik në objekt pasi për Inxhinierin e ndërtimit të paraqitur znj. Majlinda Hasa nuk është bashkëngjitur diplomë duke mos plotësuar kështu 2 kërkesa në DST pika 2 dhe 4.

2. Shoqeria ALB-KON shpk ka plotesuar me gabime formularin e ofertes pasi ne rreshtin e pare te tabelës ku cilesohet njesi sasi ka vendosur nje shume te cudithshme e cila nuk perkton as me preventivin dhe as me cfare eshte shkruar meposhte ne formularin e ofertes.
3. Grafiku I punimeve nuk eshte dhene per 30 dite pune sipas kerkesave te DST. Gjithashtu pika 6 dhe 7 e Grafikut te Punimeve jane gabim teknikisht pasi nuk mund te behet shtrimi dhe mbulimi I tubacionit me rere javen e pare kur shtrimi I tubit eshte parashikuar javen e dyte. Gjithashtu nuk mund te behet drenazhimi siper tubave javen e pare kur tubat jane parashikuar te shtohen javen e dyte.
4. Siguracioni I mjetit AA936UB eshte qartesisht I modifikuar. Data e pageses se primit te siguracionit si dhe te gjithë datat e shenuara ne koken e siguracionit jane me 06/06/2018 nderkohe qe siguracioni fillon me 06/04/2019. Kjo eshte totalisht ne shkelje te LPP si dhe nuk ploteson kerkesen e DST pika 8.a.
5. Dokumenti doganor nr. R18345 Date 19.09.2019 eshte fotokopje e pa njesuar me origjinalin duke mos plotesuar kerkesen ne DST
6. Shtojca 1/1 nuk eshte plotesuar sipas kerkesave te DST (nuk eshte zgjedhur asnje opsion).
7. Shtojca 9 e makinerive eshte e pergjithshme dhe jo e dedikuar per objektin ne fjale. Gjithashtu kjo shtojce nuk eshte plotesuar sipas kerkesave te DST.
8. Deklarata e Administratorit sipas se ciles kompania nuk eshte e angazhuar ne asnje pune publike bie ndesh me Deklaraten per punet ne process (Shtojca 10) ne te cilen paraqitet se Shoqeria ALB-KON eshte e angazhuar ne Bashkine Bulqize duke I bere keto deklarata te dyja te pavlefshme.
9. Shtojca 4 e DST per Permbushjen e Kriteve te Pergjithshme nuk eshte plotesuar sipas kerkesave te DST (nuk eshte permendur as Administratori as Ortaku) sic kerkohet citojme *“Personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë...”*.

2AF sh.p.k

1. Shoqeria nuk permbush kriterin 2.1. pika 3 pasi nuk ka paraqitur vertetimin per pagesen e taksave vendore per Bashkine Bulqize nderkohe qe e k ate rregjistruar ne QKB si ushtrim aktiviteti si dhe ka paraqitur pune te ngjashme te kryer ne kete Bashki.
2. Shoqeria nuk ka plotesuar sipas kerkesave te DST shtojcen 1/1 pasi nuk ka zgjedhur asnje opsion.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se Operatori ekonomik ” **Liqeni VII” sha** , me adresë : Lagja 14, Shkozë, Durrës, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej **2,355,490** lekë pa tvsh, dhe **2,826,588** lekë me tvsh, se është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë **Ndermarjes Ujesjelles Kanalizime Kamez** (Drejtorisë Juridike), sigurimin e kontratës, siç parashikohet në Rregullat e Prokurimit Publik, brënda 5 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi dhe jo me vone se 60 ditë për lidhjen e kontratës, duke sjellë dhe dokumentet e paraqitura në sistem (origjinale ose fotokopje të noterizuara).

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, procedura do te anulohet për mosplotësim të numrit minimal të konkurentëve në bazë të ligjit për prokurimet publike Nr.9643 datë 20.11.2006, të ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë **30.01.2020**

Ankesa: ka ose jo PO

Eshte kthyer pergjigje : **05.02.2020**

